

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Prime Materials” SHPK

Sot, më datë 19.09.2023 (Dymijë e njëzet e tre), ortakët themelues:

1. **Z.Hamza Vogli** -shtetas shqiptar, i biri i Samirit, lindur në Kavajë, i datelindjes 21.09.2004, me banim në adresen: Rruga Cen Cela; Nd. 21; H 1, Fushë Krujë; Arrameras; 1502; Krujë, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i leternjoftimit me nr. Personal K40921096E.
2. **Z.Amri Çela** -shtetas shqiptar, i biri i Albanit, lindur në Tiranë, i datelindjes 18.03.2004, me banim në adresen: Rruga Cen Çela, Arrameras, Fushë Krujë, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i leternjoftimit me nr. Personal K40318048V
3. **Z. Azad Khanalizadeh** -shtetas gjerman, i biri i Golamali, lindur në Teheran, i datelindjes 21.05.1991, me banim në adresen: Rixdorferstr82, 12109 Berlin - Gjermani, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i leternjoftimit me nr. Personal L3GK1XK9H.

Kanë vendosur themelimin e shoqërisë “Prime Materials” SHPK me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqëria Tregtare “**Prime Materials**” SHPK themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, (këtu e më poshtë Shoqëria). Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

NENI 2. Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria është Person Juridik Privat. Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin juridik-civil me emërtimin e saj “**Prime Materials**” SHPK.

NENI 3. Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka për objekt ushtrimin aktivitetit :

Tregtim me pakice të gjitha mallrave industriale e ndertimore.

Shoqëria, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj duke u bazuar tek lejet, licencat, aprovimet apo autorizimet e tjera të ligjshme të lëshuara nga institucionet qeveritare kompetente të fushës.

NENI 4 Selia e Shoqërisë

4.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë në adresen: Autostrad Fushë Krujë – Tiranë, km II-të, Arrameras, Krujë, pasuria nr. 31/47 zona kadastrale 1042. Adresa e selise mund të ndryshohet me vendim të Asamblese se Ortakeve të Shoqërisë.

NENI 5. Kapitali i Shoqërisë

PRIME MATERIALS
AKT THEMELIMI

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para i ortakeve themelues të kësaj Shoqërie në lekë.

Kontributi në para do të jetë i përbërë nga shuma prej 300,000

(Treqindmijë) Lekë, i ndare ne **3 (tre)** kuota .

Ortakët themelues të shoqërisë, i zotërojnë kuotat në shoqëri si më poshtë:

- **Hamza Vogli** – Zotërues i i 1 (një) kuote ose 33.34% te kapitalit të shoqërise me vlerë 100,000 (Njëqindmijë) lek.
- **Amri Çela** – Zotërues i i 1 (një) kuote ose 33.33% te kapitalit të shoqërise me vlerë 100,000 (Njëqindmijë) lek.
- **Azad Khanalizadeh** – Zotërues i i 1 (një) kuote ose 33.33% te kapitalit të shoqërise me vlerë 100,000 (Njëqindmijë) lek.

Kapitali themeltar është derdhur tërësisht nga ortakët themelues. Vlera dhe pagesa e e kapitalit themeltar do të kryhet në momentin e nënshkrimit të këtij statuti dhe aktit të themelimit.

NENI 6. Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj ekonomik për një afat të pacaktuar.

Neni 7. Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve - organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori - organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Administator i pare i shoqërisë do të jetë Hamza Vogli - shtetas shqiptar, i biri i Samirit, lindur në Kavajë, i datelindjes 21.09.2004 me banim në adresen: Rruga Cen Cela; Nd. 21; H 1, Fushë Krujë; Arrameras; 1502; Krujë, mbajtës i leternjoftimit me nr. personal K40921096E. me një mandat 5 (pese) vjeçar.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përrputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Eksperti Kontabël i Autorizuar i shoqërisë do të emërohet në përrputhje me me legjislacionin përkatës në fuqi dhe për çdo vit financiar shoqëria do të emërojë një ekspert kontabël për të kontrolluar aktivitetin ekonomik të shoqërisë.

NENI 9

PRIME MATERIALS
AKT THEMELIMI

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 11

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12. Legjislacioni i aplikuar

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortakët themelues dhe i vulosur përpara noterit, në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

NENI 13. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Mosmarrveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve apo ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 14. Dispozita Përfundimtare

Akti i themelimit përpilohet në 4 (katër) kopje të njëjta në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet pa vërejtje nga ortakët themelues.

ORTAKËT THEMELUES

1. Hamza Vogli

Hamza Vogli

2. Amri Çela

Amri Çela

3. Azad Khanalizadeh

Azad Khanalizadeh A. Khanalizadeh

PRIME MATERIALS
AKT THEMELIMI